

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**04.05.2022**

Drejtuar: **AZ Trading sh.p.k.**, me adresë :Bulevardi”Gjergj Fishta” Kulla “G&P”, kati parë, njësia nr.13,Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **E hapur, - Mallra**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-22990-03-24-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: **“Blerje autoboti për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta të Bashkisë Skrapar”**

Sasia e pritshme : **1 (një) Kamion lloji tip Autobot.**

Kohëzgjatja e kontratës : **15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e lidhjes së kontratës.**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 28.03.2022] [Nr. 39]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1.TIMAC sh.p.k**

M01706003U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **9.320.000 (Nëntë milion e treqind e njëzetë mijë) Lekë pa T.V.SH**

**2 ALMETA GMBH sh.p.k**

K22013001U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **9.888.888((Nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë pa T.V.SH.**

**3.AZ Trading sh.p.k**

L81515016F

Vlera: **9.950.000**(Nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë)Lekë pa T.V.SH.

#### **4.ALBANIA MOTORS**

**K41829010I**

Vlera: *Ska paraqitur ofertë ekonomike.*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

#### **1.TIMAC shpk**

**M01706003U**

*Për arsyet e mëposhtme:*

- *Ne rregjistrin tragtar, ekstraktin e QKB\_se , nuk vërteton objektin e veprimtarisë , per Shitje, Blerje apo tregetim te automjeteve te ndryshme*
- *Nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik për furnizime të ngjashme. Ne kontratën furnizime te ngjashme me institucione shteterore , Operatori Ekonomik , ka paraqitur kontratën Blerje Automjet teknologjik kamion, per grumbullimin e mbeturinave shërbimit te pastrimit me bashkinë Mirdite. Nga verifikimi rezultoi se, ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate ,operatori ekonomik Timac ka qene ne shkelje te nenit 76 germa “g” - operatori ekonomik ka pasur ne cilësinë e administratorit, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit.Rezultoi se administratori i operatorit Ekonomik Timac, ka qene administratore e Operatorit Ekonomik TIMAK , përjashtuar nga prokurimet per periudhën 21.01 2021 deri ne 21.07.2022. Publikuar ne 21.01.2021.*

*Ne rastin e përvojës realizuar ne sektorin privat, operatori ekonomik, paraqet si pune te ngjashme nje çertifikata e përfundimit me sukses të projektit me objekt, “ Projekti i furnizimit dhe montimit të superstrukturave në 37 automjete speciale komunale dhe mjete të tjera ne Shkup”. Çertifikata paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin teknik per furnizime te ngjashme me objektin e prokurimit.*

#### **2.ALMETA GMBH**

**K22013001U**

*Për arsyet e mëposhtme:*

- *Nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik, për furnizime të ngjashme.Në kontrata me Institucione shtetërore, operatori ekonomik ka paraqitur kontratë, me Objekt Makinë me 4 akse. Kontrata nuk përmbush kriterin e furnizimeve të ngjashme të kryera gjatë tre viteve tëfundit. Kontrata mban datën 04.07.2018.Në rastin e përvojës në sektorin privat , operatori ekonomik ka paraqitur dy fatura shitje, për kamion te përdorur , te cilat nuk provojnë nëse janë likujduar apo deklaruar në organet tatimore.*

#### **3.ALBANIA MOTORS**

**K41829010I**

Për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
- Për mungesë të dokumentacionit të kërkuar ne DST.

Duke i referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **AZ Trading sh.p.k., me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla "G&P", kati parë, njësia nr.13, Tiranë.**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9.950.000 (Nëntë milion e nëntëqind e ngesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".